

Përmirësimi i ambientit të biznesit në Shqipëri.

Franco Passacantando

Drejtori Ekzekutiv për Italinë, Portugalinë, Greqinë, Maltën, Shqipërinë dhe San Marinon pranë Bankës Botërore.

Faleminderit Guvernator Cani, është një kënaqësi për mua të jem këtu.

Unë jam i kënaqur që do të flas sot për përmirësimet në klimën e biznesit në Shqipëri. Për këtë prezantim kam përdorur rezultatet e një studimi të kohëve të fundit që kanë zhvilluar Shërbimet Këshillore për Investimet Financiare të Bankës Botërore mbi klimën e biznesit në Shqipëri. Ky studim është kryer përmes një vrojtimi të 500 kompanive dhe intervistave me nëpunës të qeverisë. Unë do të paraqes shkurtimisht rezultatet e këtij studimi dhe disa rekomandime që kanë dalë nga ky dhe nga studime të tjera. Përpara se të kaloj tek prezantimi dua të shpreh disa fjalë kujdesi. Ekonomistët mendojnë se kanë arritur të kuptojnë mirë faktorët që nxisin investimet në sektorin privat, por ekzistojnë ende zona të paqarta. Ka vende në të cilat, megjithëse duket se shfaqen shumë pengesa, zhvillimi i sektorit privat lulëzon dhe vende ku çdo gjë është bërë në mënyrën e duhur dhe që nuk kanë sektor privat. Ndaj, elemente të paqarta ekzistojnë. Megjithëse unë nuk do t'i përmend ato, mendoj se duhet t'i kemi parasysh gjatë diskutimit të këtyre çështjeve.

Prezantimi im fillimisht do të përmendë çështje të përgjithshme mbi politikat ekonomike dhe taksat rregullatore, që nxisin zhvillimin e sektorit privat. Më pas, do të shtjelloj se si biznesi mund të ndihmohet/lehtësohet nga qeveria. Do të vazhdoj me çështjet e qeverisë dhe të zhvillimeve të përgjithshme ekonomike, dhe në fund do të nxjerr disa përfundime.

Me lejoni të filloj me reformat politike dhe zhvillimet institucionale. Unë do të flas për investimet e huaja direkte, por çështjet janë të njëjta dhe për investimet vendase, dhe unë mendoj se ato ndihmojnë sektorin privat. Sektori privat zhvillohet aty ky investimet e huaja direkte dhe investimet vendase rriten dhe lulëzojnë. Investimet e huaja direkte drejtohen aty ku mundësitë e biznesit janë më të mëdha dhe pengesat për sipërmarrjen janë të vogla. Atëhere cilët janë faktorët kryesorë në përcaktimin e këtyre investimeve? Së pari, qëndrueshmëria makroekonomike, ku një rol sigurisht luan banka qendrore, inflacioni i ulët si dhe qëndrueshmëria politike. Sigurisht që fillimisht qëndrueshmëria politike duhet përkufizuar, dhe një nga fushat ku krijohen paqartësi është se çfarë nënkuptojmë me qëndrueshmëri dhe me siguri politike. Një studim i qartë i rregullave të lojës politike dhe i skemës institucionale. Kjo qëndrueshmëri nuk do të thotë që qeveritë nuk duhet të ndërrohen, sepse në këtë rast Italia nuk do të ishte zhvilluar gjatë 60 viteve të fundit, por nënkupton vendosjen e rregullave të qartë të lojës politike. Faktorë të tjerë janë: një sistem i përshtatshëm ligjor dhe rregullator; tregje faktorësh

financiarë, punësimi dhe të pasurive të patundshme, që funksionojnë mirë; një sistem i mirë i të drejtave të pronësisë dhe i përmbarimit të kontratave, si dhe korrupsion i ulët ose mekanizma për ta luftuar atë.

Ç'mund të bëhet nga pikëpamja e qeverisë për të lehtësuar investimet direkte vendase dhe të huaja? Mënyra tradicionale e zhvillimit të temës është shqyrtimi i nxitësve të investimit: nxitësit financiarë dhe fiskalë, shenjëstrimi i investuesve dhe i sektorëve për të zhvilluar përparësitë konkurruese të një vendi. Këta faktorë duhet të merren parasysh, megjithëse duhet pasur kujdes sepse shtrembërime të rëndësishme krijohen kur përdoren nxitës të kësaj natyre, por ato mund të përdoren dhe përdoren.

Veprimtaritë më të rëndësishme që mund të ndërmarrë qeveria për të nxitur investimet janë: ndërhyrja mbi barrierat administrative; ndërhyrja për të ulur korrupsionin; ndërhyrja për të nxitur dhe për të zhvilluar sektorë të fortë, nëpërmjet një numri mekanizmash indirektë; dhe krijimi i një mjedisi biznesi tërheqës, që nënkupton kushtet e faktorëve të prodhimit; sigurisht investim në kapitalin njerëzor dhe investime në infrastrukturë. Tashmë, theksi po vihet gjithnjë e më tepër mbi faktorët indirektë që nxisin zhvillim dhe po zhvendoset nga mbështetja direkte.

Tani më lejoni të paraqes një vlerësim të shkurtër se si Shqipëria ka përparuar nëpërmjet kombinimit të politikave makroekonomike dhe strukturore gjatë viteve të fundit. Unë do të përdor raportin e tranzicionit të Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, i cili është një dokument i shkëlqyer që jep një sinjalizim se si vende të ndryshme në tranzicion kanë ecur në një numër fushash si: sektori privat, rritja e PBB-së, administrim, privatizim, tregti dhe politika ekonomike të konkurrencës. Megjithëse Shqipëria nuk gjendet në krye të klasifikimit në disa fusha, ajo ka përparuar mirë, së pari në liberalizimin e tregtisë dhe të kursit të këmbimit ku ka marrë 4+; është bërë më pak në liberalizimin e çmimeve dhe në politikat ekonomike të konkurrencës; ndërsa ka marrë 2+ në reformën bankare. Mendoj se e kaloni klasën me 2+, por ka vende që kanë arritur dhe më shumë. Reforma infrastrukturore qëndron më pas mesatares të vendeve të tjera, por është e përafërt me ato të vendeve fqinje.

Duke kaluar tek faktorët e tjerë: matësit e administrimit dhe të ligjit, të cilët janë matës të vështirë. Siç e shikoni ka pasur përmirësime në cilësinë e llogaridhënies dhe rregullatore. Ligji është më i përzier, ku kontrolli i korrupsionit është përmirësuar, por ka pasur luhatje. Megjithatë, në përgjithësi edhe në vitin 2002 niveli është ende nën mesataren e rajonit në gjithë këto fusha.

Atëhere le të kalojmë tek rekomandimet që mund të nxirren nga analiza e mësipërme. Së pari cilat janë pengesat për investimet në sektorin privat? Fillimisht, është mungesa e zbatimit të rregullave dhe udhëzimeve. Kalimi i ligjeve nuk pasohet me forcë të mjaftueshme për të ndërtuar procedurat, kriteret dhe përgjegjësitë, dhe shpesh ka një shkallë të lartë të zgjedhjeve administrative nga agjencitë rregulluese dhe nëpunësit e tyre. Kjo është pasoja e kalimit të shumë ligjeve gjatë kohëve të fundit, por premtimi për kalimin e ligjeve është më i madh se sa masat e marra për t'i zbatuar ato.

Struktura institucionale, përgjegjësitë e individit dhe të agjencive shpesh nuk janë përcaktuar saktësisht. Investuesit në këtë vrojtim duket që nuk dinë se ku të shkojnë dhe çfarë mund të kërkojnë aty ku shkojnë. Kështu që ka dhe paparashikueshmëri për sa i përket përgjegjësi. Nuk është e nevojshme të ndërtohen rregullore shumë të detajuara dhe të sofistikuara në rast se nuk gjendet aftësia administrative për t'i administruar ato. Është më mirë që të kesh rregulla më të thjeshtë por më transparente, nëse dihet që zbatimi nuk është i mundur se sa të ngulmohet për perfeksion. Në shumë vende me ligje dhe me rregullore shumë të forta ato anashkalohen krejtësisht nga mungesa e zbatimit të tyre, ndaj është më mirë të kihen sisteme të thjeshta se sa të ndërlikuara. Ne e dimë që përmbarimi ligjor i ligjeve dhe i rregullave është i dobët, dhe mungesa e mekanizmave efektivë të përmbarimit krijon mekanizma joformalë për ekzekutimin e mosmarrëveshjeve dhe këto krijojnë një vazhde korupsioni dhe rrathësh viciozë, veçanërisht sepse kur ky mekanizëm vihet në lëvizje çdo agent sillet duke menduar që dhe agjentët e tjerë sillen në të njëjtën mënyrë. Kështu që fuqizimi i mekanizmave formalë të përmbarimit është i rëndësishëm për të krijuar një mekanizëm virtuos.

Studimi i FIAS dhe studimi mbi klimën e biznesit që ne kemi bërë sinjalizojnë tre fusha të rëndësishme përqëndrimi: administrata fiskale dhe doganore, lejet e tokës dhe të ndërtimit dhe të licencimit. Një numër rekomandimesh në secilën prej këtyre fushave janë hartuar në bashkëpunim me qeverinë. Gjithashtu, ekziston dhe një numër ngacmuesish të niveleve më të ulta, që janë të vështirë për t'u përcaktuar, por që në raste të caktuara janë po aq të rëndësishëm sa dhe rregullat kryesorë. Kështu, ky raport përcakton disa prej tyre, dhe veçanërisht rëndësinë e ekzistencës së besimit ndaj sektorit privat. Shpeshherë, sektori privat shihet me një sy armiqësor nga sektori qeveritar, ndaj është e rëndësishme të ndërtohet një klimë besimi dhe respekti reciprok.

Për të përfunduar, së pari qëndrueshmëria makroekonomike mbetet gjëja më e rëndësishme dhe Shqipëria është një shembull i mirë i rritjes së lartë, i inflacionit të ulët dhe një sektori privat në rritje. Fushat administrative dhe institucionale janë veçanërisht të rëndësishme për një vend që sapo ka kaluar hapat e parë të zhvillimit. Përparësitë konkurruese të një vendi janë veçanërisht të rëndësishme në fushën e investimeve direkte. Sigurisht që sektori financiar është i rëndësishëm, por edhe më e rëndësishme është t'i jepet përparësi administrimit dhe dhënies së llogarisë, si dhe shmangies e procedurave të dyfishta, të ndërlikuara dhe jotransparente. Në këtë këndvështrim, mund të mendohet që çfarë është arritur në infrastrukturë, duke përfshirë automatizimin e sektorit privat, duhet të ecë paralelisht me reformat rregullatore dhe me reformat në fushat juridike dhe administrative.